

Kodi i sjelljes

I miratuar nga Kuvendi i Organizatës: 5 nëntor 2018

Kodi i sjelljes i Institutit të Kosovës për Politikat Evropiane (EPIK) është i bazuar në parimet e vendosura nga ligjet dhe Kushtetuta e Kosovës dhe parimet udhëheqëse si dhe vlerat e vendosura në Deklaratën Ombrellë të Sekretariatit të Transparency International (TI-S).

Tetë (8) parimet që EPIK do ti përmbahet në baza ditore janë të paraqitura në seksionet pasuese. Kodi i sjelljes së EPIK duhet të jetë në përputhje me vlerat dhe parimet udhëheqëse të TI-së të theksuara në Deklaratën Ombrellë, i miratuar me 6 Tetor, 2001. Deklarata Ombrellë është e bashkëngjitur në *Shtojcën A*.

Respektoni vlerat morale dhe integritetin në vendin e punës;

Stafi duhet të eliminoj çfarë do sjellje që mund të krijojë ndikim negativ në jetën e tyre private dhe potencialisht mund të vendos në rrezik organizatën. Parimet e mira të etikës kërkojnë nga anëtarët e stafit të punojnë për të mirën e organizatës dhe të njëri tjetrit si individ. Ato duhet të punojnë me precizitet, qartësi dhe mirësjellje. Barazia gjinore është një virtyt i veçantë i cili duhet të respektohet, duke iu dhënë grave një rol më të fuqishëm në vendim marrje.

Transparencë për të gjitha operacionet dhe aktivitetet;

Stafi duhet të mos vendosin veten nën çfarë do obligimi/kufizimi financiar apo detyrime të tjera dhe duhet të refuzojnë çfarë do ndikimi negativ ose presion gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit. Ata duhet të mbahen përgjegjës për informimin e zyrës së menaxhmentit, dhe nëse është e nevojshme, Bordin, për dështimin e cilës do storijsë të suksesit. Në praktikë, të gjithë anëtarët e stafit duhet ti zbatojnë aktivitetet e tyre me sinqeritet dhe dinjitet për të mirën e organizatës dhe shoqërisë civile.

Shërbime për komunitetin dhe grupeve tjera shoqërore;

Anëtarët e stafit punojnë përtej interesit të projektit, dhe reflektojnë mbi atë se si të fuqizojnë besimin e organizatës në çështjet të cilat jo domosdoshmërisht financohen nga donatorët. Aftësitë e tyre janë të vlerës së lartë për përmirësimin e kushteve që kanë të bëjnë me programet e prioritizuara të organizatës. Ato duhet të jenë të hapur dhe transparent në vendim marrje që publiku të informohet.

Korrektësi në komunikim me të gjithë palët e interesuara;

Objektiviteti duhet të jetë masë kryesore në cilin do aktivitet – qoftë në administrim, hulumtim ose punë të avokimit. I gjithë stafi përgjegjës duhet të jetë objektiv dhe i paanshëm në përdorim të cilës do procedurë, gjatë zbatimit të cilës do kontratë, ose edhe gjatë rekrutimit të stafit shtesë. Kjo sugjeron që favorizimi është rreptësisht i ndaluar.

Ndikim konstant në bërjen dhe ofrimin e politikave;

Stafi duhet të kujdeset që të angazhohet dhe të ndikoj në bërjen e politikës si në nivel lokal ashtu dhe atë qendror. Është e domosdoshme për të gjitha ligjet që të respektohen. Në çfarëdo rasti të mospërputhjes, është përgjegjësi e stafit të ngrit çështjet shqetësuese dhe të avokojnë për ndryshim pozitiv që do të përfitojnë si individët brenda organizatës dhe në përgjithësi interesi i publikut.

Shmanguni çfarëdo rreziku të konfliktit të interesit;

Anëtarët e stafit duhet të shmangin cilin do konflikt të interesit që shkon kundër parimeve udhëzuese të vendosura në Deklaratën e Ombrellës së TI-s. Ata duhet të bëjnë publike të ardhurat e tyre dhe çdo investim për të shmangur çfarëdo rreziku të konfliktit të interesit.

Mos u angazhoni në mito ose çfarëdo punë tjetër të jashtëligjshme;

Çfarëdo akti të mitos ose nepotizmi është rreptësisht i ndaluar në organizatë. Stafi nuk duhet të kërkoj ose të pranoj çfarëdo shpërblimi monetar për performancën e tyre. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm për ndëshkimet ligjore dhe shpenzimet administrative duke marr parasysh se qëllimi kryesor i organizatës është të luftoj korrupsionin. Po ashtu, zyra e menaxhmentit e ka të ndaluar të abuzojnë pozitën e tyre në rekrutimin dhe promovimin e stafit në bazë të familjes ose të lidhjeve familjare, e jo në bazë të meritës.

Promovoni aktin e raportimit të shkeljeve;

Stafi inkurajohet të raportoj cilin do rast të korrupsionit brenda ose jashtë organizatës tek zyra e menaxhimit dhe Bordit dhe potencialisht tek institucionet ligjore përgjegjëse. Masa të menjëhershme duhet të për të adresuar cilën do shkelje të rregullave ose rregulloreve.

Certifikohet që ky dokument është kopja origjinale e Kodit të Mirësjelljes së EPIK-ut – Transparency International – Kosova, e miratuar nga Kuvendi i Anëtarëve më 5 nëntor 2018.

Shtesa A

Parimet e përgjithshme të Transparency International

Deklarata e vizionit, vlerat dhe parimet udhëheqëse të Transparency International (Deklarata ombrellë)

Vizioni

Për një botë në të cilën qeveria, biznesi, shoqëria civile dhe përditshmëria e qytetarëve është e çliruar nga korrupsioni.

Vlerat

Transparenca, llogaridhënia, integriteti, solidariteti, guximi, drejtësia, demokracia.

Parimet udhëheqëse

Ne jemi organizatë e shoqërisë civile e përkushtuar ndaj parimeve në vijim:

1. Si ndërtues koalicionesh, ne do të punojmë me të gjitha organizatat dhe individët, me korporatat dhe organizatat fitimprurëse dhe jofitimprurëse, me qeveritë dhe institucionet ndërkombëtare që janë të përkushtuara në luftën kundër korrupsionit, dhe në kuadër të kornizës së politikave dhe prioriteteve të përcaktuara nga organet udhëheqëse të organizatës sonë.
2. Ne zotohemi të jemi të hapur, të ndershëm dhe të përgjegjshëm në marrëdhëniet me të gjithë akterët me të cilët punojmë dhe me njëri tjetrin.
3. Në punën tonë do të jemi demokratik, politikisht të paanshëm dhe neutral.
4. Ne do të dënojmë miton dhe korrupsionin fuqishëm dhe guximshëm, sa herë që identifikohet nga burime të besueshme, edhe pse nuk kërkojmë të ekspozojmë rastet individuale të korrupsionit.
5. Qëndrimet tona do të jenë të bazuara analiza të zëshme, objektive, profesionale dhe standarde të larta të hulumtimit.
6. Ne do të pranojmë vetëm fonde të cilat nuk do ta rrezikojnë mundësinë tonë për të adresuar çështjet lirshëm dhe objektivisht.
7. Ne do të ofrojmë raporte të sakta dhe me kohë për të gjithë akterët relevant.
8. Ne do të respektojmë dhe do të inkurajojmë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore.
9. Ne jemi për përkushtuar të ndërtojmë, të punojmë me dhe përmes kapitujve nacional në tërë botën.
10. Ne do të angazhohemi që përfaqësimi në organet tona udhëheqëse të ketë diversitet dhe barazi.

Pragë, 6 Tetor 2001